



**Ambasada e Italisë  
Tiranë  
Kancelaria Konsullore  
Tiranë**

**Informacion për mbrojtjen e personave fizikë  
përsa i përket përpunimit të të dhënave personale  
me qëllim ofrimin e shërbimeve konsullore  
(me përjashtim të lëshimit të vizave dhe të praktikave të shtetësisë)  
(Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (BE) 2016/679, neni 13)**

Përpunimi i të dhënave personale me qëllim ofrimin e shërbimeve konsullore do të bazohet në parimet e ligjshmërisë, të korrektësisë dhe të transparencës në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive themelore të personave fizikë.

Sikurse specifikohet në vijim, shërbimet në fjalë i ofrohen shtetasve italianë dhe, në rast se janë të huaj, banues në juridiksionin konsullor të Ambasadës së Italisë në Tiranë dhe/ose përkohësisht të pranishëm në këtë juridiksion.

Shërbimet i referohen këtyre sektorëve: gjendja civile, regjistrimi në AIRE (gjendja civile e italianëve që banojnë jashtë vendit), votimi jashtë vendit, dhënia e kodit fiskal, dhënia e PIN-it për shërbimet telematike të Agjencisë së të Ardhurave, konfirmim i lejeve të drejtimit të automjeteve (vetëm në vendet extra-europiane dhe në kushte të caktuara), çregjistrim i automjeteve nga Regjistri Publik i Automjeteve (PRA), lëshimi i dokumenteve të udhëtimit (pasaporta e dokumente udhëtimi të përkohshme), lëshimi i letërnjoftimit, asistencë sociale (ndihma në të holla, hua me të drejtë kthimi, riatdhesime) juridiksion vullnetar (ndër të cilat birësime ndërkombëtare), ndihmë gjyqësore (për shembull, në rast të të miturve për të cilët kërkohet kujdestaria, të personave të zhdukur, apo të personave të burgosur ose të ndaluar), administrim i interesave privatë (ndër të cilat trashëgimitë), veprimtaritë e çertifikimit dhe legalizimit e, nëse nevojitet, funksione të sektorit të lundrimit dhe të shkollave.

Për këtë qëllim, parashtrijmë informacionet që vijojnë:

1. Titullar i përpunimit është Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (MPJBN) e Republikës së Italisë e cila, në rastin konkret, vepron përmes Ambasadës së Italisë në Tiranë, Rruga Papa Gjon Pali II, nr. 2 1010 Tiranë (Shqipëri), telefon 0035542275900; posta elektronike: cancelleria.tirana@esteri.it; posta elektronike e certifikuar: [amb.tirana.consolare@cert.esteri.it](mailto:amb.tirana.consolare@cert.esteri.it). Në funksion të shërbimit në fjalë MPJBN mund të veprojë në bashkëpunim me subjekte të tjera publike, bashkëtitullarë të përpunimit, të cilët do të specifikohen në vijim.
2. Për pyetje apo ankesa personi i interesuar mund të kontaktojë Përgjegjësin për Mbrojtjen e të Dhënave personale (PMDH) të MPJBN (adresa postare: Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale, Piazzale della Farnesina 1, 00135 ROMA, telefon +39 06 36911 (centrali), posta elektronike: [rpd@esteri.it](mailto:rpd@esteri.it), posta elektronike e certifikuar: [rpd@cert.esteri.it](mailto:rpd@cert.esteri.it)
3. Të dhënat personale të përpunuara kanë për qëllim vetëm ushtrimin e funksioneve konsullore të cilat përcaktohen nga Dekreti Legjislativ nr. 71 i datës 3 shkurt 2011 – Rregullore dhe funksione të zyrave konsullore. Në vijim pasqyrohen nenet që i njohin Zyrave konsullore detyrën e ofrimit të çdo shërbimi, të ndara në funksion të natyrës së përfituesve (shtetas italianë dhe, nëse është e nevojshme, të huaj), të vendbanimit të tyre si dhe të pranisë së tyre të përkohshme jashtë vendit
  - a. Përfitues me banim jashtë vendit (vetëm shtetasit italianë)
    - Regjistrim në AIRE: neni 9 i D. Legj. Nr. 71/2011;
    - karton i letërnjoftimit: neni 22 i D. Legj. Nr. 71/2011;
    - ndihmë në të holla: neni 24 i D. Legj. Nr. 71/2011.
  - b. Përfitues që përkohësisht banojnë jashtë shtetit (shtetas italianë dhe të Vendeve të BE-së):
    - Dokument udhëtimi i përkohshëm (i quajtur ndryshe dhe ETD nga anglishtja Emergency Travel Document) për shtetasit italianë dhe për shtetasit e Vendeve të Bashkimit Europian të cilët përfaqësohen nga Zyra konsullore italiane: neni 23 i D. Legj. Nr. 71/2011.
  - c. Përfitues me banim të përhershëm apo të përkohshëm jashtë vendit (shtetas italianë dhe, në rastet e përmendura, edhe të huaj):
    - pasaportë elektronike e zakonshme dhe pasaportë e përkohshme: neni 21 D. Legj. nr. 71/2011;
    - votimi jashtë vendit: neni 55, D. Legj. 71/2011;
    - Gjendja civile: neni 6, nenet 12-20, neni 30, neni 52 dhe neni 62 D. Legj. Nr. 71/2011 (edhe për shtetasit e huaj, për shtetasit me banim të përkohshëm jashtë vendit vetëm në raste të veçanta);
    - Dhënia e kodit fiskal dhe e PIN-it për shërbimet telematike të Agjencisë së të Ardhurave, çregjistrim i automjeteve nga PRA; neni 52 i D. Legj. Nr. 71/2011 (edhe për shtetasit e huaj);
    - Dhënie huaje me të drejtë kthimi: neni 24 i D. Legj. Nr. 71/2011;
    - Riatdhesime: nenet 25 dhe 26 të D. Legj. Nr. 71/2011;
    - Funksione noteriale dhe juridiksion vullnetar, ndër të cilat birësimet ndërkombëtare: nenet 28 – 35 të D. Legj. Nr. 71/2011;
    - Funksione në fushën e mosmarrëveshjeve, të policisë gjyqësore apo të ndihmës gjyqësore, ndër të cilat ndihmesa në rastin e kërkimit të kujdestarisë së të miturve dhe e personave të zhdukur apo të personave burgosur apo të ndaluar: nenet 36-42 të D. Legj. Nr. 71/2011;
    - Funksione që kanë të bëjnë me administrimin e interesave privatë, ndër të cilat trashëgimitë: nenet 43-47 të D. Legj. Nr. 71/2011;
    - Funksione në fushën e dokumentimit administrativ; nenet 52-54 dhe 76-77 të D. Legj. Nr. 71/2011 (edhe për shtetasit e huaj);
    - Funksione në fushën e lundrimit, ndër të cilat kontrolli mbi lundrimin dhe trafikun detar kombëtar jashtë vendit, ngjytja dhe zbritja e personelit detar në anijet kombëtare, përmbushje e detyrimeve që kanë të bëjnë me regjimin administrativ të anijeve, dhënia apo përtëritja e ditarit të udhëtimit; dhënia, përtëritja apo shtyrja e afatit të çertifikatave të sigurisë së anijeve kombëtare jashtë vendit, funksione hetimore në rastet e hetimeve që kanë të bëjnë me incidentet detare apo me aksidentet që mund të pësojë personeli lundrues: nenet 48-51 të D. Legj. Nr. 71/2011 (dhe për shtetasit e huaj);
    - Funksione në fushën shkollore, ndër të cilat lëshimi i deklaratave të vlefshmërisë, njoftimi për rezultatin e provimeve shtetërore, praktikat për njohjen e diplomave, pagesa e personelit të shkollave dhe kontributet për shkollat dhe entet administruese: neni 56 i D. Legj. Nr. 71/2011 (dhe për shtetasit e huaj).

4. Ofrimi i këtyre të dhënave, të cilat do të regjistrohen pranë Zyrës konsullore në një skedar të veçantë si shkresor ashtu dhe informatik, në bazë të ligjit është i detyrueshëm. Refuzimi mund të sjellë mos ofrimin e shërbimit.
5. Përpunimi i të dhënave, i kryer nga personeli i ngarkuar posaçërisht, do të zhvillohet si në mënyrë manuale ashtu dhe të automatizuar. Për rrjedhojë, personi i interesuar asnjëherë nuk do të jetë përfutës i një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar të të dhënave të tij.
6. Të dhënat do t'i bëhen me dije subjekteve të parashikuara nga normativa italiane përkatëse, sikurse parashtrohen në listën vijuese:
  - Regjistrimi në AIRE: Komuna e vendbanimit të fundit në Itali (ligji nr. 470 i datës 27 tetor 1988 Gjendja civile dhe regjistrimi i shtetasve italianë jashtë vendit) ISTAT (nenet 6 dhe 6bis të D. Legj. 322/1989-Norma mbi Sistemin statistik kombëtar dhe mbi riorganizimin e Institutit kombëtar të statistikes), INPS, për pagesën e pensioneve jashtë vendit, (neni 50, paragrafi 2 i D. Legj. Nr. 82 i datës 7 mars 2005– Kodi i Administratës Dixhitale/CAD dhe ndryshimet në vijim) dhe, nese eshte e rast, Roja e Finances (neni 37 i D.P.R. 223/1989 – Rregullorja anagrafike e popullsisë banuese);
  - Gjendja civile: Bashkia kompetente (e identifikuar në baze të nenit 17 të Dekretit të Presidentit të Republikës/D.P.R. i 3 Nentorit 2000, nr.396 – Rregullorja për rishikimin e thjeshtesimit të rendit të Gjendjes Civile); Prefektura kompetente, për ndryshimet e emrit/mbiemrit (neni 89 i D.P.R. 396/2000); INPS, për pagesën e pensioneve jashtë vendit, (neni 50, paragrafi 2 i D. Legj. Nr. 82 i datës 7 mars 2005– Kodi i Administratës Dixhitale/CAD dhe ndryshimet në vijim)
  - Votimi jashtë vendit: Bashkia e vendbanimit apo regjistrimi në AIRE dhe në Ministrinë e Brendshme (Ligji nr. 459 i datës 27 dhjetor 2001 – normativa për ushtrimin e së drejtës së votës së shtetasve italianë me banim jashtë vendit);
  - Pasaporta elektronike e zakonshme apo pasaporta e përkohshme: Ministria e Brendshme (neni 16 i Ligjit nr. 1185, datë 21 nëntor 1967 dhe Rregullorja (KE) nr. 444 e 2009);
  - Dokument udhëtimi i përkohshëm: Ministria e Brendshme italiane nëse kërkuesi është shtetas italian ose autoriteti kompetent kombëtar nëse kërkuesi është shtetas i një vendi tjetër të BE-së (vendim i BE-së i datës 25 qershor 1996 (96/409/PESC) dhe neni 23 i Dekretit Legjislativ nr. 71, datë 3 shkurt 2011);
  - Kartoni i letërnjoftimit: Bashkia e regjistrimit në AIRE dhe Ministria e Brendshme (neni 288 i Dekretit Mbretëror /RD 6 maj 1940, nr. 365 dhe neni 1, gërma d) i Dekretit të Kryetarit të Këshillit të Ministrave /DPCM nr. 437 datë 22 tetor 1999);
  - Kodi fiskal dhe PIN-i për shërbimet telematike të Agjencisë së të Ardhurave: Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Dekret i Ministrisë së Financave nr. 281, datë 17 maj 2001 – Rregullorja që përcakton normativën në fushën e lehtësive në lidhje me dhënien e kodit fiskal dhe me mënyrat e paraqitjes së deklaratës së pagesës së tatimeve për tatimpaguesit me banim jashtë vendit);
  - Automjete: Regjistri Publik i Automjeteve (PRA (Dekreti Legjislativ nr. 285, datë 30 prill 1992 – Kodi i ri rrugor);
  - Ndihma në të holla: të dhënat janë të ruajtura në aktet e Zyrës Konsullore dhe të futura në portalin SIBI të MPJBN, në të cilin kanë akses vetëm Zyrat ministrorë kompetente;
  - Dhënia e huave me të drejtë kthimi: Kuestura dhe Agjencia kompetente e të Ardhurave (Tërheqja) (neni 17 i Dekretit Legjislativ nr. 46, datë 26 shkurt 1999 dhe neni 1 i Dekret Legjit nr. 193, datë 22 tetor 2016);
  - Riatdhesime: Prefekurat kompetente, Kuesturat, Stacionet e Karabinierëve, ASL (*Ndërmarrjet Spitalore Vendore*) dhe Bashkitë, autoritetet e huaja kompetente, si dhe në rastet e largimit për arsye urgjence, Pergjegjesit e Zonave dhe forcat e ndihmes italiane dhe/ose të huaja (Qarkore e MPJ nr. 14, datë 20.11.1998 “riatdhesime konsullore”; Konventa e Berlinit e datës 10.02.1937; Qarkore e MPJ nr. 7 e datës 04.04.1979 “kthimi i eshtrave”; Udhëzim i Kryesisë së Këshillit të Ministrave i datës 23.09.2011);
  - Birësime ndërkombëtare: Autoritetet kompetente të huaja, Komisioni për Birësimet Ndërkombëtare, Ministria e Drejtësisë (Departamenti për Drejtësinë e të miturve), Gjykata për të Mitur (Ligji nr. 184, datë 4 maj 1983);
  - Kërkimi i personave të zhdukur dhe ndihmesa ndaj të burgosurve apo personave të ndaluar: Autoritetet kompetente të huaja, Kuesturat kompetente, Stacionet e Karabinierëve dhe Prokuroritë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme – Interpol (Konventa e Strasburgut 2 datës 21 mars 1983 mbi transferimin e personave të dënues: Qarkore nr. 4 e datës 14.7.2011 “Njoftim i Autoritetit Gjyqësor për kryerjen e veprave penale”);
  - Te mitur për të cilët kërkohet kujdestaria: Autoritetet kompetente të huaja, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme (Ligji nr. 64, datë 15 janar 1994; Rregullorja (KE) nr. 2201/2003 Bruksel II; Kushtetuta Interpol e datës 13 qershor 1956);
  - Trashëgimitë: Bashkitë italiane të vendbanimit të fundit në Itali apo të regjistrimit në AIRE dhe Agjencia e të Ardhurave kompetente për territorin, për trashëgimitë e çelura jashtë vendit (neni 46 i Dekretit Legjislativ nr. 71, datë 3 shkurt 2011), Kancelaria e Gjykatës kompetente për trashëgimitë e çelura në Itali (neni 622 i Kodit Civil; neni 52 i Dispozitave për zbatimin E Kodit Civil dhe të dispozitave kalimtare);
  - Certifikata dhe legalizime: dokumentet në fjalë i lëshohen personit të interesuar apo një personi të tretë të ngarkuar prej tij;
  - Funksione në fushën e lundrimit: në bazë të procedimeve administrative, Ministria e Infrastrukturës dhe e Transporteve, Komanda e Përgjithshme e Njësisë së Kapitenerive të Portit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria për Politikën Bujqësore dhe Pyjore, Autoriteti Gjyqësor, Autoriteti Detar, Instituti Kombëtar i Asistencës për Aksidentet e Punonjësve, Bashkitë e vendbanimit dhe mjekët e besuar (RD nr. 327, datë 30 mars 1942 – Kodi i Lundrimit, DPR nr. 328, datë 15 shkurt 1952 – Rregullore për ekzekutimin e Kodit të Lundrimit, si dhe normativa e posaçme në fuqi e zbatueshme për raste të veçanta);
  - Funksione në sektorin shkollor: Ministria e Arsimit, Universitetit dhe e Kërkimit/MIUR, Zyrat Shkollore Rajonale/USR, Shkolla dhe Universitete, MEF dhe Zyra Territoriale e Kontrollit të Shtetit/RTS (Dekreti Legjislativ nr. 64 i datës 13 prill 2017).
7. Për arsye të sigurisë juridike dhe lëshimit të certifikatave, të dhënat do të ruhen për një kohë të pa caktuar, me përjashtim të gjurmëve të gishtave të përfutara për pasaportën elektronike, të cilat ruhen vetëm për periudhën e nevojshme për lëshimin e dokumentit, e, gjithësesi për një periudhë deri në tridhjetë ditë.
8. Personi i interesuar mund të kërkojë të ketë akses në të dhënat e tij personale dhe, në përputhje me dispozitat në fuqi, të kërkojë ndryshimin e tyre. Në përputhje me rastet e parashikuara nga normativa në fuqi, me përjashtim të pasojave të mundshme si rrjedhojë e procedurës administrative, ai mund të kërkojë gjithashtu kufizimin e përpunimit apo kundërshtimin e përpunimit. Në këto raste, personi i interesuar duhet të paraqesë kërkesë pranë Ambasadës së Italisë në Tiranë, duke vënë në dijeni dhe PMDH të MPJBN.
9. Nëse gjykoni se të drejtat tuaja në fushën e privatesisë janë shkelur, personi i interesuar mund të paraqesë ankesën pranë PMDH të MPJBN. Përsakohe që nuk është i kenaqur nga pergjigjja, mund t'i drejtohet Garantuesit për Mbrojtjen e të Dhënave personale (Piazza Venezia, 11, 00187 ROMA, tel. 0039 06 696771 (centrali), posta elektronike: [garante@gpdp.it](mailto:garante@gpdp.it), posta elektronike e certifikuar: [protocollo@pec.gpdp.it](mailto:protocollo@pec.gpdp.it)).